



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**

**DEPARTAMENTI I MONITORIMIT**

**Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik**

**Katër Vite më Vonë**

**Ri-Përcjellja e Rasteve të Trazirave të Marsit 2004 në  
Sistemin e Drejtësisë Penale në Kosovë**

**Korrik 2008**

## TABELA E PËRMBAJTJEVE

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>3</b>
<b>1. HYRJE.....</b>	<b>4</b>
<b>2. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË PARË LIDHUR ME TRAZIRAT ..... E MARSIT .....</b>	<b>5</b>
<b>3. VËSHITËSITË NË MBLEDHJEN E DËSHMIVE .....</b>	<b>6</b>
3.1. DËSHMITARËT DËSHTUAN TË PARAQITEN PRANË GJYKATAVE .....	6
3.2. DËSHMITARËT KONTRADIKTOR.....	7
<b>4. VONESAT .....</b>	<b>9</b>
4.1. MBAJTJA E KALLËZIMEVE TË “REJA” PENALE .....	10
4.2) VONESAT PËR TË FILLUAR SHQYRTIMIN KRYESOR .....	11
4.3. AKTGJYKIMET E SHKRUARA TË NXJERRURA ME VONESA TË TEPËRTA .....	11
<b>5. DËNIMET .....</b>	<b>13</b>
5.1. MOTIVET ETNIKE TË INJORUARA .....	13
5.2. KUALIFIKIMI I GABUAR I VEPRËS.....	14
5.3. DËNIMET E ULËTA .....	15
5.4. DËNIMET NËN MINIMUM.....	16
5.5. SHFRYTËZIM GJITHËPËRFSHIRËS I DËNIMEVE TË SUSPENDUARA .....	16
<b>6. PROBLEMET ME ANKESA.....</b>	<b>17</b>
6.1. DËSHTIMI PËR T’I KORRIGJUAR MANGËSITË GJATË PROCEDURAVE NË SHKALLË TË PARË .....	17
6.2. ZYRA E PROKURORIT TË KOSOVËS MBAN SHKRESAT E LËNDËVE.....	19
<b>7. KONKLuzion .....</b>	<b>21</b>
<b>8. REKOMANDIME .....</b>	<b>23</b>
<b>ANEKSI I.....</b>	<b>24</b>
<b>ANEKSI II.....</b>	<b>26</b>

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Ngjarjet dramatike dhe të dhunshme të marsit 2004 ishin një prapakthim serioz në luftën e Kosovës për t'u bërë një shoqëri tolerante multi-etnike që respekton të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe sundimin e ligjit.

Ngjarjet nuk mund të zhbëhen, por duhet të ndiqet veprim i duhur ligjor. Testi se a garanton një shoqëri moderne në mënyrë të duhur mbrojtje për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit, qëndron aty se a siguron sistemi i drejtësisë që individët të cilët marrin pjesë në dhunë etnikisht të motivuar, siç ishte ajo që ndodhi në mars 2004 të përballen me drejtësi.

Për këtë arsye OSBE monitoroi dhe më pas ri-monitoroi për së afërmi rastet që lidhen me trazirat e marsit 2004. OSBE publikoi raportin e parë në dhjetor 2005, përderisa ky raport mbulon zhvillimet që nga dhjetori 2005 deri në mars 2008.

Në këtë kontekst, OSBE vazhdon të vërejë shumë nga mangësitë e njëjta të theksuara në raportin e mëparshëm të dhjetorit 2005. Gjykatat e Kosovës ende kanë vështirësi për të siguruar deklaratatë të dëshmitarëve (si nga qytetarët privat ashtu edhe nga zyrtarët e policisë)<sup>1</sup> Dëshmitarët kanë dështuar të paraqiten pranë gjykatave dhe kanë dhënë deklaratatë kontradiktore me ato që kishin dhënë më herët. Ka dështim të përgjithshëm për të akuzuar dhe dënuar kryesit e pandehur sipas veprës penale adekuate dhe seriozitetit të veprës. Gjykatat shpesh nuk kanë marrë parasysh motivin etnik si faktor rëndësues që i paraprin shumë veprave të kryera penale. Të pandehurit fajtorë për vepra të rënda penale siç është vërja në zjarr e monumenteve religjioze, lëndimi i personave (përfshirë këtu zyrtarët e policisë) shpesh morën dënime të lehta, ekzekutimi i të cilëve madje edhe ishte suspenduar në shumë raste.<sup>2</sup> OSBE gjithashtu ka vërejtur probleme të reja siç janë ato me procedurat ankimore.

OSBE është gjithashtu e brengosur me numrin e vogël të ndjekjeve penale. Bazuar në statistikat e UNMIK-ut,<sup>3</sup> prej marsit 2004 deri në prill 2008, janë ngritur aktakuza ndaj 242 individëve për vepra penale të kryera gjatë trazirave të marsit 2004 (206 nga prokurorë vendor dhe 36 nga prokurorë ndërkombëtarë) në lidhje me rastet e trazirave të marsit 2004. Veç kësaj, 157 persona u përballën me akuza pranë gjykatave për kundërvajtje. Që nga dhjetori 2005, ka pasur vetëm 21 raste të reja (që përfshijnë 42 të pandehur). Kështu që nga marsi 2004 policia dhe prokurorët kishin ngritura akuza vetëm kundër përafërsisht 400 personave. Duke supozuar se më shumë se 50,000 njerëz, siç raportojë, morën pjesë në trazira<sup>4</sup>, dh e Shërbimi Policor i Kosovës pranoi

---

<sup>1</sup> Mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunimi me ta është problem i përgjithshëm në sistemin e drejtësisë penale të Kosovës (shih Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Siguria dhe Mbrojtja e Dëshmitarëve në Kosovë: vlerësim dhe rekomandime*, nëntor 2007).

<sup>2</sup> Një “dënim i suspenduar” është alternativë kundrejt ndëshkimit me burg. Gjyqtari mund ta suspendojë dënimin në atë mënyrë që të i jap kryesit vërejtje e cila do të arrinte qëllimin e ndëshkimit duke shpallur dënimin i cili nuk do të ekzekutohet” (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, (“Kodi i Përkohshëm Penal”), i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, *Mbi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës*, 6 korrik 2003, neni 42).

<sup>3</sup> Informacioni i ofruar OSBE-së nga një zyrtar nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut me 30 prill 2008.

<sup>4</sup> Sipas Grupit Ndërkombëtar për Kriza, Policia e UNMIK-ut numëroi 33 trazira të mëdha që përfshinin një numër prej afro 51.000 pjesëmarrësve. Grupi Ndërkombëtar për Kriza, Kolapsi në Kosovë, Raporti për Evropën Nr. 155, 22 prill 2004, faqe 15. OSBE është në dijeni se kjo llogaritje nuk tregon se sa persona në të vërtetë kanë kryer krime gjatë trazirave sepse shumë “pjesëmarrës” kanë mund të jenë

përafërsisht 1,400 ankesa në lidhje me krimet e pandehura të kryera gjatë këtyre ngjarjeve.<sup>5</sup> Andaj, shumë kryes mund të mos të përballen kurrë me ndëshkim.<sup>6</sup>

Gjykimet penale jo vetëm që vendosin dritë mbi ngjarjet e kaluara por sigurojnë që kriminelët të ballafaqohen me drejtësi dhe të drejtat e viktimës të mbrohen. Numri i vogël i ndjekjeve penale dështon të luftojë në mënyrë adekuate mosndëshkimet dhe të dërgojë porosi të qartë se dhuna etnike siç ishte ajo e marsit 2004 nuk do të tolerohet. Kjo gjithashtu zbeh besimin e publikut dhe dobëson sundimin e ligjit, kur ata që kryejnë krime nuk dalin para drejtësisë.

## 1. HYRJE

Me 17 dhe 18 mars 2004, një valë e trazirave të dhunshme përfshiu Kosovën, që ishte shkaktuar nga dy incidente të cilat ishin perceptuar si etnikisht të motivuara.<sup>7</sup> Demonstratat, edhe pse kur filluan dukeshin spontane, me shpejtësi u përqendruan në serbët e Kosovës anembanë Kosovës. Si rezultat, nëntëmbëdhjetë persona ishin vrarë (11 shqiptarë të Kosovës dhe 8 serb të Kosovës), më shumë se 900 persona ishin lënduar (përfshirë këtu 65 policë ndërkombëtar dhe 58 oficerë të Shërbimit Policor të Kosovës), dhe më shumë se 800 ndërtesa ishin shkatërruar ose dëmtuar (përfshirë këtu 29 kisha ose manastire).<sup>8</sup> Vlerësohet se më shumë se 50.000 njerëz morën pjesë në trazira.<sup>9</sup>

Seksioni për monitorimin e Sistemit Juridik<sup>10</sup> pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë (OSBE) që nga marsi 2004 deri më sot ka monitoruar për së afërmi hetimet dhe

---

vetëm vëzhgues. Megjithatë, nëse 50,000 njerëz kanë marrë pjesë në trazira, duket e arsyeshme të vlerësohet se më shumë se 400 persona kanë kryer vepra penale.

<sup>5</sup> Veprat përfshijnë 19 vrasje, 14 tentim vrasje, 36 sulme të rënda, 83 sulme, 629 djegie, 121 thyerje, 247 dëme penale, 33 vjedhje, 12 sulme me granata, 20 plaçkitje, dhe 153 vjedhje (burimi: UNMIK, Shënim për media – Azhurnim mbi ndjekjet dhe dënimet në lidhje me trazirat e marsit 204, 14 mars 2008).

<sup>6</sup> Komiteti për të Drejtat e Njeriut shprehu “bregën[at] e veta lidhur me mosndëshkimin e disa kryesve të [...] krimeve etnikisht të motivuara të kryera që prej qershorit të vitit 1999, përfshirë këtu edhe ato që janë kryer gjatë marsit 2004” (shih Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Observimet e Gjetura nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Kosovë (Serbi), KB. Dok. CCPR/C/UNK/CO/1, 14 gusht 2006, paragrafi 12). Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara gjithashtu nënvizoi se “nuk ka pasur progres qenësor në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve që lidhen me dhunën e marsit 2004” (Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2006/707, 1 shtator 2006, paragrafët 18 dhe 26). Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu theksoi se “Nevojiten përpjekje më të mëdha për të përfunduar ndjekjet e mbetura penale lidhur me dhunën e marsit 2004. Ato ndjekje duhet të përcaktohen si prioritet i lartë. Udhëheqësit lokal duhet t’i ftojë publikisht dëshmitarët që të bashkëpunojnë sepse progresi është penguar për shkak të dështimit të dëshmitarëve për të dhënë dëshmi” (Id., paragrafi 33).

<sup>7</sup> Incidenti i parë ishte shtënia drejt një të riu serb të Kosovës në fshatin Čaglavica/Çaglavicë (afër Prishtinës/Priština) me 15 mars, që qoi në bllokim të rrugës kryesore Prishtinë/Priština-Shkup/Skopje nga ana e serbëve të Kosovës mu në dalje të Prishtinës/Priština. Incidenti i dytë, me 16 mars, ishte vdekja e tre fëmijëve shqiptarë të Kosovës e shkaktuar nga mbytja në lumin Ibër/Ibar afër qytetit Zubin Potok (regjioni Mitrovicë/Mitrovica).

<sup>8</sup> Shih Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara Misioni në Kosovë, S/2004/348, 30 prill 2004, faqet 1 dhe 2 (në dispozicion në [www.un.org/Docs/sc/sgrep04.html](http://www.un.org/Docs/sc/sgrep04.html)).

<sup>9</sup> Burimi: Reuters, *Detajet e KB-ve mbi dhunën në shkallë të lartë në Kosovë*, raporti për media i 22 marsit 2004. Shih gjithashtu Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, Raporti për Evropën Nr. 155, 22 prill 2004.

<sup>10</sup> Sipas mandatit të vet, Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik, pjesë e Departamentit për Monitorim të Misionit të OSBE-së në Kosovë, monitoron sistemin e drejtësisë për pajtueshmëri me

gjykimet. Me monitorimin e 73 rasteve të trazirave të marsit 2004 që ndodhen (gjykatat e qarkut, komunale dhe ato për kundërvajtje) në mes të dhjetorit 2005 dhe marsit 2008,<sup>11</sup> OSBE-ja jep vazhdimësi të raportit të parë të vitit 2005.<sup>12</sup>

## 2. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË PARË LIDHUR ME TRAZIRAT E MARSIT

Në dhjetor 2005, OSBE-ja ka publikuar raportin e vet të parë i cili fokusohej në reagimin e sistemit juridik të Kosovës ndaj trazirave të marsit 2004.<sup>13</sup> Së pari, raporti trajtoi problemet lidhur me mbledhjen e dëshmimeve. OSBE-ja përshkroi çështjet mbi frikësimin e mundshëm të dëshmitarëve dhe shqetësimet lidhur me sigurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Veç kësaj, shprehi problemet në lidhje me mbledhjen e dëshmimeve për shkak të dislokimit të dëshmitarëve dhe palëve të dëmtuara, policët ndërkombëtar të cilët largoheshin nga Kosova pas përfundimit të misionit të tyre, dhe dëshmitarët të cilët dështonin të paraqiten pranë gjykatave. Shqetësim tjetër ishin vonesat.

Së dyti, raporti analizoi praktikën e akuzimeve dhe dënimeve të gjykatave të Kosovës dhe nënvizoi akuzimet jo adekuate kundër disa kryesve (të cilët ishin akuzuar për vepra shumë të lehta) dhe shfrytëzimin e procedurës për marrëveshje rreth deklarimit të fajësisë<sup>14</sup> (jo i lejuar sipas ligjit në Kosovë).<sup>15</sup> Sa i përket dënimeve, OSBE vërejt një trend drejt butësisë, duke paraqitur raste të dënimeve nën minimumin e paraparë me ligj. Veç kësaj, raporti vlerësoi shfrytëzimin e rrethanave lehtësuese dhe atyre rënduese, duke ardhur në përfundim se gjykatat shpesh dështuan të marrin parasysh rrethanat rënduese (siç janë motivi etnik, ose mënyra se si është kryer vepra penale). Për më tepër, gjykatat dështuan të arsyetojnë vendosjen e dënimeve të lehta me aplikimin e rrethanave speciale lehtësuese.

Raporti përfundoi se “organet hetimore dhe ato gjyqësore nuk janë marrë me këto raste, me aq zell sa është kërkuar” dhe se “duke vendosur dënime të lehta për

---

ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe rekomandon zgjidhje të qëndrueshme që do të siguronin se këto standarde do të respektohen.

<sup>11</sup> Shtojca I e këtij raporti përmban statistika të UNMIK-ut mbi ndjekjet e përgjithshme penale të rasteve të trazirave të marsit 2004 dhe informata shtesë mbi rastet e monitoruara nga OSBE për këtë raport. Shtojca II përmban një tabelë që tregon informata lidhur me praktikën e dënimeve nga gjykatat e Kosovës lidhur me rastet e trazirave të marsit 2004 të monitoruara nga OSBE.

<sup>12</sup> Misioni i OSBE në Kosovë, Reagimi i sistemit të drejtësisë ndaj trazirave të marsit 2004, dhjetor 2005.

<sup>13</sup> Vlen të ceket se Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik gjithashtu përfshiu edhe një pasqyrë të shkurtë të hetimeve dhe gjykimeve lidhur me trazirat e marsit 2004 në një raport të mëhershëm (shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *Krimi, Dënimi dhe Paraburgim (prill 2003-tetor 2004)*, tetor 2004, faqe 100-103).

<sup>14</sup> Shpesh i përdorur në sistemet e të drejtës zakonore, marrëveshjet mbi fajësinë mund të definojnë si “marrëveshje mes ndjekjes dhe mbrojtjes si rezultat i së cilës i akuzuari ndryshon deklaratën nga i pafajshëm në fajtor si përgjigje për ofertën e prokurorit (për shembull, për të hedhur poshtë akuzat më të rënda kundër të akuzuarit) apo nëse gjykatësi ka bërë jo-formalisht të ditur se do të minimizoj dënimin nëse i akuzuari deklarohet fajtor” (*Oxford Dictionary of Law*, Oxford University Press, edicioni i pestë, f. 368).

<sup>15</sup> Sipas Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, koncepti i deklarimit të pafajësisë, edhe pse nuk është i rregulluar, ka “evoluar në *jurisprudencë* në gjykatat e Kosovës.” Megjithatë, Kosova nuk ka sistem juridik që përfshinë precedentë gjyqësor prej nga vendimet ligjore obligojnë gjykatat më të ulëta dhe krijojnë ligje të reja. Andaj, sipas mendimit të OSBE-së, përpos nëse është e vendosur saktësisht nën ligj të Kosovës, deklarimi i fajësisë nuk është i lejueshëm edhe po që se është e pranuar në “*jurisprudencë*.”

shumicën e rasteve të ndërlidhura me trazirat, gjykatat kanë dështuar në dërgimin e mesazhit të qartë për dënimin e sjelljeve të tilla, dhe si duket nuk i kanë konsideruar veprat penale të cilat kanë rrjedhur nga trazirat e Marsit 2004 si aq serioze.”<sup>16</sup>

### 3. VËSHIRËSITË NË MBLEDHJEN E DËSHMIVE

Në raportin e parë OSBE-ja përfundoi se vështirësitë në sigurimin e dëshmive krijuan pengesën më të madhe për ndjekjen e suksesshme penale. Kjo nuk ka ndryshuar në masë të madhe. Edhe pse shumë dëshmitarë dhe palë të dëmtuara dolën të dëshmojnë para gjykatave të Kosovës, OSBE-ja megjithatë vërejtë shumë vështirësi në sigurimin e deklaratave inkriminuese gjatë gjykimit. Disa dëshmitarë, përfshirë edhe zyrtarët e policisë, dështuan të paraqiten pranë gjykatës, për derisa të tjerët ndryshuan deklaratat e tyre të dhëna gjatë hetimeve. Të dyja këto patën efekte negative serioze në fuqinë e rasteve e prokurorisë.

#### 3.1. Dëshmitarët dështuan të paraqiten pranë gjykatave

Sipas ligjit të Kosovës, dëshmitarët e kanë *detyrë* të paraqiten para gjykatës.<sup>17</sup> Veç kësaj, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës (“Kodi i Përkohshëm Penal”) parasheh se në qoftë se dëshmitarët e ftuar në mënyrë të rregullt dështojnë të paraqiten para gjykatës pa ndonjë arsyetim të vlefshëm, gjykata mund t’i sjell dëshmitarët me forcë dhe t’i gjobit ata deri në 250 Euro.<sup>18</sup>

Përkundër këtyre dispozitave ligjore, OSBE-ja ka vëzhguar disa raste, veçanërisht në regionin e Mitrovicës/Mitrovica, ku dëshmitarët dështuan të paraqiten dhe të dëshmojnë, përfshirë këtu edhe zyrtarë të policisë të cilët ishin dëshmitarë okular (ose viktima) të incidenteve, deklaratat e të cilëve ishin qenësore për prokurorinë.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur ishte akuzuar për sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.<sup>19</sup> Gjatë gjykimit, dy pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës, të ftuar në mënyrë të rregullt dështuan të paraqiten tetë herë ndërmjet marsit 2007 dhe janarit 2008. Në rastin e njëjtë, dy policë tjerë dështuan të paraqiten tre herë. Një polic tjetër i cili kinse ishte lënduar nga i pandehuri me 17 mars 2004, gjithashtu, ndërmjet marsit dhe gushtit 2007 dështoi të paraqitet pranë gjykatës në tri raste të ndara.

Në një gjykim i cili filloi me 28 shkurt 2007 pranë Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, një i pandehur u përball me akuza të

<sup>16</sup> Shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *Reagimi i Sistemit Juridik ndaj Trazirave të marsit 2004*, dhjetor 2005, faqe 34.

<sup>17</sup> Neni 158(3), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale në Kosovë, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, *Mbi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale në Kosovë*, 6 korrik 2003 (“Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale”).

<sup>18</sup> Neni 167(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Për më tepër, sipas nenit 167 (2), “edhe pas kësaj refuzon të dëshmojë, atëherë mund të burgoset. Burgimi zgjat derisa dëshmitari nuk pranon të dëshmojë apo derisa dëshmimi i tij bëhet i panevojshëm, ose derisa procedura të përfundojë, por më së shumti një muaj.” Pjesëtarët e forcave ushtarake dhe pjesëtarët e policisë nuk mund të burgosen, por për refuzimin e dëshmimit të tyre njoftohet komanda e tyre përkatëse (Neni 167(4), Kodi i Procedurës Penale).

<sup>19</sup> Neni 317(2), Kodi i Përkohshëm Penal.

pjesëmarrjes në turmë që kryen dhunë,<sup>20</sup> vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme<sup>21</sup> dhe vjedhje të rëndë.<sup>22</sup> Gjykata ftoi në mënyrë të rregullt si dëshmitarë ose palë të dëmtuara 40 pjesëtar të komunitetit Ashkali në Vushtrri/Vuçitrn. Megjithatë, me 28 shkurt dhe 4 prill 2007 gjykata shtyu seancën e gjykimit për shkak se nuk u paraqit asnjë dëshmitar/palë e dëmtuar. Për derisa disa prej tyre ishin zhvendosur pas trazirave, disa të tjerë thjesht nuk u paraqiten. Andaj, me 16 maj 2007 gjykata vendosi t'i mbaj seancat e ardhshme gjyqësore pa palët e dëmtuara.<sup>23</sup>

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Gjilan/Gnjilane ku përfshihej procedura kundër një të pandehuri për tentim vjedhjeje të rëndë që kinse e kishte kryer në dëm të një serbi të Kosovës pas trazirave të marsit 2004, një polic i Shërbimit Policor të Kosovës, i ftuar në mënyrë të rregullt si dëshmitar i rastit, dështoi të paraqitet në dy seanca të njëpasnjëshme gjyqësore me 25 maj dhe 20 qershor.<sup>24</sup>

Në rastet e sipërpërmendura, autoritetet gjyqësore u mbështeten ekskluzivisht në procedurën e fletëthirrjeve në vend se t'i përdorin edhe mjetet tjera në dispozicion, siç është urdhri për t'i sjellur me forcë dëshmitarët në sallë ose dënimi me gjobë. Si rezultat, disa dëshmitarë, përfshirë këtu edhe zyrtarët e Shërbimit Policor të Kosovës, shkelën detyrën e tyre për të dëshmuar,<sup>25</sup> dhe penguan ndjekjen penale të kryesve të mundshëm të trazirave të marsit 2004.<sup>26</sup>

### 3.2. Dëshmitarët kontradiktor

Në disa raste, dëshmitarët të cilët para autoriteteve hetuese kishin dhënë deklarata inkriminuese kundër të dyshuarve, gjatë shqyrtimit kryesor kundërshtuan deklaratat e tyre.

Në një rast para kolegjit ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit, dy të pandehur u përballën me akuza për nxitje të urrejtjes

<sup>20</sup>Neni 200(2), Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 28 qershor 1997 ("Ligji Penal i Kosovës").

<sup>21</sup>Neni 157(3), Ligji Penal i Kosovës.

<sup>22</sup>Neni 253(1)(3) dhe (4), Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>23</sup>Vlen të ceket se, në seancën e gjykimit me 1 nëntor 2007, pesë palë të dëmtuara më në fund u paraqiten para gjykatës por dhanë deklarata që e lirinin të pandehurin nga fajësia. Palët e dëmtuara deklaruan se qeveria e Kosovës kishte ndërtuar shtëpi te reja për ta, duke shtuar se "kur nuk e kishin pa të pandehurin dhe se nuk e njihnin atë." Përfundimisht me 19 dhjetor 2007 gjykata e shpalli të pandehurin fajtor për pjesëmarrje në turmë që kryen dhunë, duke e liruar atë nga akuzat tjera.

<sup>24</sup>Vlen të ceket se, nuk ka pasur nevojë për fletëthirrje shtesë, pasi që prej 9 gushtit 2006 i akuzuari u deklarua fajtor për akuzën kundër tij duke përfunduar kështu procedurën e provave.

<sup>25</sup>Zyrtarët e policisë që dështuan t'i përgjigjen ftesave të gjyqit do të duhej të përballen me procedura disiplinuese (shih Manualin e Politikës dhe Procedurave, Rregullat e Shërbimit dhe Sjelljes të Shërbimit Policor të Kosovës, Politika Nr. P-1.16, Rregulli I dhe Rregulli III-R. Shih gjithashtu Politikën për Paraqitje Gjyqësore të Zyrtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës, 1 tetor 2002, paragrafi IV.A.2).

<sup>26</sup>OSBE-ja gjithashtu vëzhgoi vështirësi në mbledhjen e dëshmimeve si rezultat i asaj që personat përfundonin misionin e tyre, siç edhe është nënvizuar në raportin e parë lidhur me trazirat e marsit. Për shembull në një rast lidhur me trazirat e marsit 2004, me 13 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica në mungesë provash *inter alia* liroi dy të pandehur nga akuzat, pasi që dy policët ndërkombëtar përfunduan misionin e tyre dhe nuk mund të dëshmonin para gjykatës.

etnike, nacionale, raciale, fetare, përçarjes ose jo-tolerancë,<sup>27</sup> shkaktim të rrezikut të përgjithshëm,<sup>28</sup> vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme,<sup>29</sup> dhe pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale.<sup>30</sup> Me 19 shkurt 2007, një dëshmitarë i prokurorisë thelbësisht ndryshoi deklaratën e tij të dhënë në polici. Në përgjigje ndaj pyetjes së prokurorit ai deklaroi se nuk ishte frikësuar, mirëpo nuk sqaroi se çka e shtyu atë të tërheq dëshminë. Ngjashëm, një tjetër dëshmitar i prokurorisë, në seancën e mbajtur me 21 shkurt 2007 ndryshoi deklaratën e dhënë në polici dhe para prokurorëve ndërkombëtar në raste të mëhershme. Ai me këmbëngulësi mohoi përmbajtjen e deklaratave të tij të mëparshme e madje edhe refuzoi që ta njoh nënshkrimin e vet.

Në një rast para Gjykatë së Qarkut në Prishtinë/Priština, dy të pandehur u përballën me akuza për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm.<sup>31</sup> Në seancës gjyqësore me 15 tetor 2007 gjykata dëgjoi deklaratën e policit i cili gjatë hetimeve, në koleksionin e fotografive<sup>32</sup> kishte identifikuar njërin nga të pandehurit si pjesëmarrës në incidentet e 17 marsit 2004 në Ferizaj/Uroševac. Megjithatë, gjatë seancës gjyqësore, polici i tha gjykatës se nuk mund të konfirmonte se i pandehuri gjendej në mes të kryesve.<sup>33</sup> Prokurori kërkoi nga ai që të sqarohet lidhur me ndryshimet në deklaratat e tij,<sup>34</sup> por kryetari i trupit gjykues nuk e lejoi pyetjen.<sup>35</sup>

Është e paqartë se a kanë qenë ndryshimet në deklaratat për shkak të kalimit të kohës, mungesës së interesit/besimit në drejtësi, marrëveshjeve me të pandehurit ose frikës dhe trembjes.<sup>36</sup> Në çfarëdo rasti, gjykatat dështuan të kryejnë hulumtime të detajuara sa i përket arsyeve se përse dëshmitarët ndryshuan deklaratat e tyre, dhe të ofrojnë masa mbrojtëse kur është e nevojshme. Prokurorët nuk përdorën kurrfarë masa tjera (siç është kërcënimi t'i akuzojë ata për dhënie të dëshmisë së rrejshme)<sup>37</sup> për t'i detyruar dëshmitarët t'i marrin sërish parasysh deklaratat e tyre. Brengosëse është se,

---

<sup>27</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/4, *Mbi Ndalimin e Nxitjes së Urrejtjes, Përçarjes ose Mos-durimit Kombëtar, Racor, Fetar dhe Etnik*, 1 shkurt 2000, nenet 1.3 dhe 1.4.

<sup>28</sup> Neni 157(1), Ligji Penal i Kosovës.

<sup>29</sup> Neni 164(1), Ligji Penal i Kosovës.

<sup>30</sup> Neni 200(1), Ligji Penal i Kosovës (vetëm një ose dy të pandehur ishin akuzuar me këtë vepër penale).

<sup>31</sup> Neni 291, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>32</sup> Polici gjithashtu i dha prokurorit përshkrim të saktë të dukjes fizike të të pandehurit.

<sup>33</sup> Vlen të ceket se, dukja fizike e të pandehurit (i shkurt dhe tullac) e bën atë lehtë të njohur.

<sup>34</sup> Sipas nenit 364, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>35</sup> Prokurori mund të ketë qenë në gjendje t'i tejkaloj ndryshimet duke e detyruar policin të pranoj se i pandehuri i cili ndodhej në sallë të gjykimit dukej i ngjashëm me personin të cilin polici më parë e kishte identifikuar në foto. Brengosëse është se, gjyqtari ndaloi prokurorin që të shtroj pyetje legjitime dhe si rrjedhojë ndaloi prokurorin t'i shfaq ndryshimet në deklaratat e policit.

<sup>36</sup> Siç ka raportuar më parë OSBE-ja, frikësimi i dëshmitarëve është problem të cilin autoritetet e Kosovës duhet ta adresojnë si prioritet të lartë (shih raportin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, *Siguria dhe Mbrojtja e Dëshmitarëve në Kosovë: vlerësim dhe rekomandime*, nëntor 2007). Shih gjithashtu raportin e fundit të Human Rights Watch, *Agienda e të Drejtave të Njeriut për një Kosovë të Re*, shkurt 2008, faqe 2.

<sup>37</sup> Neni 307, Kodi i Përkohshëm Penal.



disa zyrtarë të Shërbimit Policor të Kosovës ishin në mes të dëshmitarëve të cilët dhanë deklaratat të cilat binin në kundërshtim me deklaratat e tyre të mëparshme.<sup>38</sup>

Si shënim më pozitiv, OSBE-ja gjithashtu ka monitoruar një rast ku gjykata (kolegj ndërkombëtar) ka urdhëruar masa ndëshkuese ndaj dëshmitarëve jo-bashkëpunues:

Rasti pranë kolegjit ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Priştina, përfshiu procedurën kundër pesë të pandehurve për veprat e pandehura penale të pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale,<sup>39</sup> vepra të rënda penale kundër sigurisë publike,<sup>40</sup> nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar dhe etnik dhe jo-tolerancës.<sup>41</sup> Me 15, 21 dhe 22 nëntor 2007 tetë dëshmitarë të prokurorisë dëshmuan para gjykatës por i ndryshuan deklaratat e dhëna më parë në polici. Andaj, në mbylljen e shqyrtimit kryesor, kolegji i përcolli shkresat e lëndës te prokurori<sup>42</sup> që të hetoj dhe në fund të filloi procedurën penale për dëshmi të rrejshme<sup>43</sup> kundër dëshmitarëve.

Gjykatat dhe prokurorët duhet të përdorin më shpesh masat e këtilla ndëshkuese, pasi që ato ndihmojnë që të shtyjnë dëshmitarët e ardhshëm që të bashkëpunojnë dhe të japin dëshmi të vërteta.

#### 4. VONESAT

Sipas ligjit vendor, gjykatat duhet t'i zhvillojnë procedurat pa zvarritje.<sup>44</sup> Ngjashëm, standardet ndërkombëtare ndalojnë vonesat e paarsyeshme dhe përshkruajnë se gjykimet duhet të mbahen brenda kohës së arsyeshme.<sup>45</sup> Kjo garanci nënvizon “rëndësinë e dhënies së drejtësisë pa vonesa të cilat mund të rrezikojnë efikasitetin dhe besueshmërinë e saj”.<sup>46</sup> Në rastet penale, gjithashtu i shmanget asaj që individët “të qëndrojnë shumë gjatë në gjendje të paqartësisë lidhur me fatin e tyre.”<sup>47</sup>

Në Kosovë, mungesa e kapacitetit në sistemin juridik dhe ngarkesa me lëndë i kontribuojnë vonesave në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale.<sup>48</sup> Megjithatë,

<sup>38</sup> Përpos që paraqet vepër penale, kjo sjellje gjithashtu shkel Manualin e Proceduarve dhe Politikës së Shërbimit Policor të Kosovës, Politikën për Paraqitje Gjyqësore të Zyrtarëve të Shërbimit Policor të Kosovës, Fq-1.41, Paragrafi IV.C.2.c, dhe kështu mund të qoj në ngritje të hetimeve të brendshme dhe procedurave disiplinuese.

<sup>39</sup> Neni 200, Ligji Penal i Kosovës.

<sup>40</sup> Neni 164, Ligji Penal i Kosovës.

<sup>41</sup> Neni 1, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/4.

<sup>42</sup> Sipas nenit 338(3), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>43</sup> Neni 307, Kodi i Përkohshëm Penal. Vlen të ceket se, më 25 janar 2008, gjykata shpalli të pandehurit fajtor dhe i dënoi ata me burgim prej dy deri në tetë vjet.

<sup>44</sup> Neni 5(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>45</sup> Neni 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe neni 14(3)(c), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

<sup>46</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *H. kundër Francës*, 10073/82, Aktgjykim, 24 tetor 1989, paragrafi 58. Veç kësaj, me kalimin e kohës, viktimat dhe dëshmitarët mund të ngurrojnë që të dëshmojnë dhe kujtesa e tyre mund të zbehet.

<sup>47</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Stogmuller kundër Austrisë*, 10073/82, Aktgjykim, 10 nëntor 1969, paragrafi 5.

<sup>48</sup> Megjithatë, vlen të ceket se shtetet kanë për detyrë të “organizojnë sistemin e tyre juridik në atë mënyrë që t’i lejojnë gjykatat të veprojnë në pajtueshmëri me kërkesat nga Neni 6(1) përfshirë këtu edhe gjykimin “brenda kohës së arsyeshme”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 9737/79, Aktgjykim, 13 korrik 1983, paragrafi 29.

serioziteti dhe shkalla e incidenteve të ngjara gjatë trazirave të marsit 2004 imponoi detyrë mbi autoritetet publike që të vepronin me dinjitetin më të madh për hetimin dhe ndjekjen penale të kryesve të pandehur. Me gjithë këtë, shpesh rastet nuk kishin përfunduar brenda kohës së duhur.

Në veçanti, përkundër rekomandimeve në raportin e parë lidhur me trazirat e marsit, OSBE-ja vazhdon të vërej (a) vonesa të paarsyeshme në përcjelljen e kallëzimeve penale që kanë të bëjnë me rastet e “reja”; (b) vonesat në fillimin e shqyrtimeve kryesore pas konfirmimit të aktakuzave; dhe (c) vonesat e paarsyeshme gjyqësore në lëshimin e aktgjykimeve të shkallës së parë.

#### 4.1. Mbajtja e kallëzimeve të “reja” penale

Standardet ndërkombëtare vendosin obligimin tek “autoritetet publike” që denjësisht të hetojnë shkeljet e të drejtave të njeriut,<sup>49</sup> ku përfshihen si policia ashtu edhe prokurorët. Sipas ligjit vendor, hetimet duhet të drejtohen nga ana e prokurorit kompetent i cili do të bëjë “mbikëqyrje[n] e punës së policisë gjyqësore gjatë hetimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale.”<sup>50</sup> Megjithatë, zakonisht prokurorët nuk mund të fillojnë hetimet derisa policia të mos sjell kallëzimin penal për veprën e pandehur. Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, sapo policia të njoftohet qoftë nëpërmjet paraqitjes së kallëzimit penal apo në ndonjë mënyrë tjetër për veprë penale të dyshuar e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, pa vonesë dhe jomë vonë se njëzet e katër orë nga marrja e këtij informacioni informon prokurorin publik. Më pastaj policia duhet të siguron raporte të tjera dhe të dhëna plotësuese sa më parë që të jetë e mundur.<sup>51</sup>

Megjithatë, OSBE ka vërejtur shembuj ku policia ka përcjellur dosjet tek prokurori aq vonë sa janë tre vjet e gjysmë pas trazirave të marsit 2004.

Në shtator 2007, policia e UNMIK-ut ia përcolli prokurorit komunal në Prizren një rast të ri të lidhur me trazira e marsit 2004, që përfshinte 13 të dyshuar. Policia pandehte se të dyshuarit kishin kryer veprën penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm.<sup>52</sup> Megjithatë, me 5 tetor 2007 Gjykata Komonale në Prizren refuzoi propozim akuzën të ngritur kundër njërit nga të pandehurit për shkak se statuti i kufizimeve për veprat e pandehura ka skaduar.<sup>53</sup> Është e mundshme se dhjetë rastet e mbetura të cilat ndajnë fakte identike gjithashtu do të hedhen poshtë nëse ato marrin të njëjtin kualifikim ligjor.

Me 23 nëntor 2006, policia parashtrori pranë Gjykatës për Kundërvajtje në Gjilan/Gnjilane, tri kallëzime penale që përfshinin prishje të pandehur të

---

<sup>49</sup> Sipas Komitetit për të Drejtat e Njeriut, kur hetojnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut, autoritetet publike duhet të “ushtrojnë përkushtim të duhur për të parandaluar, dënuar, hetuar ose riparua dëmin e shkakuar” (shih Komentin e Përgjithshëm të Komitetit për të Drejtat e Njeriut Nr. 31 [80], *Natyra e Obligimeve të Përgjithshme Ligjore të Vendosura mbi Shtetet Palë të Konventës*, 29 mars 2004, paragrafi 8).

<sup>50</sup> Neni 46(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>51</sup> Neni 200(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>52</sup> Neni 291(1) Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>53</sup> Vlen të ceket se, statuti i kufizimeve skadoi për shkak se prokurori komunal akuzoi të pandehurin me vepër shumë të butë nga pikëpamja e fakteve të pandehura. Faktet përkrahnin aktakuzën për veprën penale të nxitjes së urrejtjes kombëtare (Neni 115, Kodi i Përkohshëm Penal), duke përfshirë rrethanat rëndësuese të paragrafit (3) ose (5) të nenit 291. Dënimet më serioze mbajnë statut më të gjatë të kufizimeve (shih nenin 90, Kodi i Përkohshëm Penal).

rregullit dhe qetësisë në Gjilan/Gnjilane gjatë trazirave të marsit 2004. Gjykata ka hedhur poshtë rastet për shkak të mungesës së provave. Akuzat është dashur të hidhen poshtë në cilindo rast për shkak se statuti i kufizimeve kishte skaduar.<sup>54</sup>

Është e paqartë pse iu desh policisë kaq kohë e gjatë për t'i përfunduar hetimet dhe t'i transferoj dosjet tek autoritetet kompetente për ndjekje penale. Kjo, megjithatë, rezultoi në vonesa të paarsyeshme në procedurat penale. Në rastin më të keq, lënda u hodh poshtë për shkak të kalimit të kohës.<sup>55</sup>

#### **4.2) Vonesat për të filluar shqyrtimin kryesor**

Sipas Kodit të Procedurës Penale, menjëherë pas pranimit të aktakuzës, gjyqtari duhet të kontrolloj se a është në përputhje me ligjin.<sup>56</sup> Nëse po, gjyqtari duhet të caktojë menjëherë seancën e konfirmimit.<sup>57</sup> Veç kësaj, kryetari i kolegjit duhet ta caktojë shqyrtimin kryesor posa aktakuza të merr formën e prerë, ose më së largu brenda një muaji pasi aktakuza ta ketë marr formën e prerë.<sup>58</sup>

OSBE vërejtë në disa raste se gjyqtarët dukshëm caktuan gjykime jashtë afatit kohor të paraparë me Kodin e Procedurës Penale.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prizren, me 29 qershor 2007 gjyqtari konfirmoi një aktakuzë të ngritur gati tre vjet më herët, me 6 gusht 2004.<sup>59</sup> Gjykimi nuk filloi deri me 11 tetor 2007.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, me 16 maj 2004 prokurori ngriti një propozim akuzë e cila ngarkonte një të pandehur me pjesëmarrje në turmë që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare.<sup>60</sup> Shqyrtimi kryesor filloi me 21 shkurt 2006, gati dy vjet më vonë.<sup>61</sup>

#### **4.3. Aktgjykimet e shkruara të nxjerra me vonesa të tepërta**

<sup>54</sup> Shih nenin 27(4), Ligji mbi Kundërvajtjet (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr. 23/79).

<sup>55</sup> Edhe pse kanë kaluar katër vite që nga trazirat e marsit 2004, OSBE është në dijeni se Shërbimi Policor i Kosovës dhe Policia e UNMIK-ut ende posedojnë dosje të hetimeve për disa kryes të veprave në trazirat e marsit 2004. Pasi që këto lëndë ende nuk janë transferuar tek prokurorët, rastet akoma nuk kanë filluar (intervista e OSBE-së me një prokuror qarku dhe punëtorët e prokurorisë). Shih gjithashtu Komisioni i Komuniteteve të Evropës, Kosova nën Rezolutën e KB-ve 1244 - 2007 Raport mbi Progresin, COM(2007)663, 6 nëntor 2007, sipas të cilit task forca e policisë e cila heton trazirat e marsit 2004 ende ka 750 raste "nën shqyrtim" (në faqen 46).

<sup>56</sup> Neni 306(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>57</sup> Shih nenin 309(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Në proceduarën e shkurtër (në të cilën nuk ka seancë për konfirmim), gjyqtari duhet ta caktojë gjykimin menjëherë pasi të vërtetojë se aktakuza është në pajtim me ligjin (shih nenin 466(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale).

<sup>58</sup> Neni 319(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Në të kundërtën kryetari i kolegjit duhet ta njoftojë kryetarin e gjykatës i cili më pas, nëse kjo është e nevojshme, merr hapa për të caktuar shqyrtimin kryesor.

<sup>59</sup> Aktakuza ngarkonte të pandehurin me pjesëmarrje në turmë që kryen vepër penale (neni 320(1), Kodi i Përkohshëm Penal).

<sup>60</sup> Neni 318, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>61</sup> Si shënim, rasti përfshinte procedurë të shkurtër për të cilën ligji parasheh caktim të "menjëhershëm" të shqyrtimit kryesor (neni 466(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale).

Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, aktgjykimi do të përpilohet me shkrim brenda 15 ditëve nga shpallja e tij në qoftë se i akuzuari ndodhet në paraburgim, dhe brenda 30 ditëve në rastet e tjera.<sup>62</sup> Më pas gjykata duhet të ja dërgoi një kopje të aktgjykimit prokurorit, të pandehurit dhe palës së dëmtuar.<sup>63</sup>

OSBE ka monitoruar raste ku gjykatat nxjerrën aktgjykimet e shkruara disa muaj pas shpalljes së aktgjykimit.

Në një rast pranë një kolegji ndërkombëtar para Gjykatës së Qarkut në Gjiilan/Gnjilane, gjashtë të pandehur janë gjykuar për vepra penale që përfshinin vrasje,<sup>64</sup> vrasje në tentativë,<sup>65</sup> dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm.<sup>66</sup> Me 19 maj 2005 kolegji shpalli aktgjykimin e vet, duke dënuar të pandehurit prej dy vite e gjysmë deri në 16 vjet burgim. Megjithatë, gjykata nuk nxori aktgjykimin e shkruar deri me 29 nëntor 2006, më shumë se 18 muaj më vonë.<sup>67</sup> Veçanërisht shqetësuese është se, tre të pandehurit ndodheshin në paraburgim gjatë tërë kësaj kohe.<sup>68</sup>

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prizren, me 15 shtator 2004 gjykata dënoi një të pandehur për dy akuza të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare,<sup>69</sup> dhe për një akuzë të pjesëmarrjes në turmë që kryen vepra penale. Megjithatë, gjykata i dorëzoi atij aktgjykimin në formë të shkruar vetëm me 3 shkurt 2006, më se 16 muaj më vonë.<sup>70</sup>

Përpilimi dhe dorëzimi i vonuar i aktgjykimit të shkruar në mënyrë jo të drejtë zvarritën procedurën. Vonesa të tilla nuk i atribuohen ndërlikimeve rreth rastit ose sjelljes së të pandehurit, andaj edhe nuk mund të arsyetohen.<sup>71</sup> Rrjedhimisht, autoritetet gjyqësore kanë shkëlur garancinë e “kohës së arsyeshme” e cila, sipas standardeve ndërkombëtare, gjithashtu zbatohet edhe në procedurat e ankesës.<sup>72</sup> Veç kësaj, pasi që të pandehurit nuk kanë mundur të parashtrojnë ankesë kundër

<sup>62</sup> Neni 395(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Megjithatë, “[n]ëse aktgjykimi nuk përpilohet brenda asaj kohe, kryetari i kolegjit do ta informojë kryetarin e gjykatës për arsyet lidhur me këtë. Kryetari i gjykatës do të merr masat e nevojshme që aktgjykimi të përpilohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se tridhjetë ditë nga shpallja e tij nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim dhe dyzet e pesë ditë në raste të tjera” (*id.*).

<sup>63</sup> Neni 395(3), (4) dhe (5), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>64</sup> Neni 146, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>65</sup> Nenet 146 dhe 20, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>66</sup> Neni 291, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>67</sup> Për shënim, deri më sot Gjykata Supreme ende nuk ka vendosur lidhur me ankesat e parashtuara nga të akuzuarit.

<sup>68</sup> Kjo ngrit shqetësime shtesë lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit të të pandehurit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vazhdimisht ka theksuar se vazhdimi i paraburgimit ndaj të dyshuarit është i kundërligjshëm përpos në rastet kur “autoritetet kompetente të vendit kanë treguar zell të veçantë gjatë rrjedhës së procedurës” (shih *Labita kundër. Italisë*, 26772/95, Aktgjykimi, 6 prill 2000, paragrafi 170).

<sup>69</sup> Neni 184(1) dhe (2), Ligji Penal i Kosovës.

<sup>70</sup> Për shënim, Gjykata e Qarkut në Prizren lëshoi vendimin ankimor pas një vitit, me 26 janar 2007.

<sup>71</sup> Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Šakanovič kundër Sllovenisë*, 32989/02, Aktgjykimi, 13 dhjetor 2007, paragrafi 39.

<sup>72</sup> Shih Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Koment i Përgjithshëm, Nr. 13, “*Barazia pranë gjykatës dhe e drejta për gjykim korrekt dhe publik pranë gjykatës të themeluar sipas ligjit*”, 13 prill 1984, paragrafi 10. Shih gjithashtu Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Delcourt kundër Belgjikës*, 2689/65, Aktgjykimi, 17 janar 1970, paragrafi 25.

aktgjykimit para se ta pranojnë atë në formë të prerë, ata ishin privuar nga e drejta e tyre fundamentale për mjet efektiv ligjor për një periudhë të qenësishme kohore.<sup>73</sup>

## 5. DËNIMET

Trazirat e marsit 2004 shkaktuan kërcënim dhe dëm serioz për jetë, siguri të përgjithshme dhe tolerancë etnike në Kosovë.<sup>74</sup> Gjykatat kanë pasur për detyrë të dërgojnë porosi të fortë drejt popullit të Kosovës se incidente të tilla nuk do të tolerohen.

Dënimet e lehta kanë qenë një nga kritikata kryesore në raportin e parë lidhur me trazirat e marsit.<sup>75</sup> Përkundër rekomandimeve në atë raport, OSBE vazhdon të vërejë se gjykatat në përgjithësi kanë dhënë dënime të lehta.

Në shumicën e rasteve, gjykatat vendosën dënime gati, madje edhe nën minimumin ligjor. Veç kësaj, gjykatat shpesh suspenduan ekzekutimin e këtyre dënimeve duke zëvendësuar dënimet edhe ashtu të ulëta me dënime alternative.

Në shumë raste të monitoruara, shkak i dënimeve të ulëta mund të ketë qenë dështimi që motivi etnik të konsiderohet si rrethanë rëndësuese. Në raste tjera, gjykatat vendosën dënime të lehta për shkak se prokurorët akuzuan personat me vepra më pak serioze se sa ato që mbështeteshin me faktet e pandehura.

Dënimet e lehta dhe nën-akuzat janë probleme tipike në sistemin juridik në Kosovë.<sup>76</sup> Megjithatë, kjo nuk i arsyeton gjykatat për lëshimin e dënimeve në rastet e trazirave të marsit 2004 të cilat nuk reflektojnë në mënyrë adekuate seriozitetin e krimeve të kryera.

### 5.1. Motivet etnike të injoruar

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “të trajtosh dhunën dhe brutalitetin e nxitur në baza raciale, në baraspeshë të njëjtë me raste që nuk kanë konotacion racist, do të ishte si të mbyllësh sytë para natyrës specifike të veprimeve që janë veçanërisht destruktive për të drejtat fundamentale. Dështimi për të bërë dallim në mënyrën se si trajtohen situatat që në esencë janë të ndryshme, mund të përbëjë trajtim të pajustificueshëm i cili nuk është në përputhje me nenin 14 të Konventës.”<sup>77</sup>

Ligji vendor i Kosovës parasheh se një ndër faktorët që duhet të merret parasysh kur vendoset mbi dënimin është “motivet për kryerjen e veprës.”<sup>78</sup>

<sup>73</sup> Shih neni 13, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>74</sup> Shih Kapitujt XIII, XV dhe XXV të Kodit të Përkohshëm Penal.

<sup>75</sup> Shih raportin e parë lidhur me trazirat e marsit, faqe 27.

<sup>76</sup> Shih Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Mbrojtja e Dëshmitarëve në Sistemin e Drejtësisë Penale* (prill 2003), faqe 43; shih gjithashtu Misioni i OSBE-së në Kosovë *Krimi, Dënimi dhe Paraburgimi* (dhjetor 2004), faqe 39.

<sup>77</sup> Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, 43577/98 dhe 43579/98, Aktgjykim, 24 shkurt 2004, paragrafi 158.

<sup>78</sup> Neni 64(1), Kodi i Përkohshëm Penal.

Megjithatë, OSBE vëren se gjykatat gjerësisht kanë dështuar të marrin parasysh motivin etnik si rrethanë rëndësuese në rastet lidhur me trazirat e marsit 2004.

Në një rast pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština, me 7 mars 2007 gjykata e shpalli të pandehurin fajtor për djegien e shtëpisë që i përkiste një serbi të Kosovës gjatë trazirave të marsit 2004 në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Gjykata e dënoi atë për shkaktim të dëmit të rëndë të përgjithshëm (vepër penale që parasheh dënim me burg prej një deri në tetë vjet),<sup>79</sup> dhe e ndëshkoi atë me një vjet e gjysmë burgim. Përkundër motivit të dukshëm etnik të të pandehurit, gjatë vendosjes së dënimit gjykata gjeti: “Gjykata gjatë matjes së kohëzgjatjes së dënimit të të akuzuarit [...] vlerësoi të gjitha rrethanat e rëndësishme lidhur me matjen dhe caktimin e dënimit.”

Në një rast tjetër pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë/Mitrovica, me 20 dhjetor 2005, një i pandehur i mitur ishte dënuar për pjesëmarrje në turmë që kryen vepër penale. Gjykata gjeti se nuk kishte “rrethana të veçanta rëndësuese” në rast, dhe e dënoi të pandehurin me dy muaj shërbim për komunitet.<sup>80</sup>

Në rastet e sipërme, gjykatat nuk morën parasysh motivin etnik si faktor rëndësues, përkundër motivacionit të qartë etnik në veprat e kryera penale. Shqetësuese është se OSBE vërejt një rast që pohon të kundërtën:

Në një rast lidhur me trazirat e marsit 2004 pranë Gjykatës Komunale në Lipjan/Lipljane ku përfshiheshin tre të pandehur të ngarkuar me pjesëmarrje në turmë që kryen vepër penale,<sup>81</sup> me 5 qershor 2007 gjykata dënoi të pandehurit me gjashtë muaj burgim. Është befasuese se gjykata morri parasysh si *rrethanë lehtësuese* “situatën e përgjithshme të krijuar me 18 mars 2004.”

Dështimi i gjykatave për ta marrë parasysh motivin etnik si rrethanë rëndësuese sugjeron se ato i shikuan incidentet e marsit 2004 si krime “ordinere”. Është dashur të dërgohet një porosi më e fuqishme se dhuna e motivuar etnikisht nuk do të tolerohet.

## 5.2. Kualifikimi i gabuar i veprës

Në disa raste të trazirave të marsit 2004, prokurorët ngarkuan të pandehurit me vepra të lehta penale përderisa gjasat faktike mbështetnin aktakuza për krime më serioze.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Pejë/Peć, me 25 janar 2005 prokurori ngarkoi të pandehurin me pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, vepër penale që ndëshkohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.<sup>82</sup> Megjithatë, edhe sipas aktakuzës edhe sipas aktgjykimit të datës 21 shkurt 2006, grupi jo vetëm që ka penguar policinë por edhe kishte hedhur gurë drejt policëve dhe i kishte vënë zjarr shtëpive që i përkasin serbëve të Kosovës. Andaj, veprimet mbështetnin akuza për vepra

<sup>79</sup> Neni 291(5), Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>80</sup> Shih neni 28, Ligji për të Mitur i Kosovës, i miratuar përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/8, mbi *Ligjin për të Mitur të Kosovës*, 20 prill 2004.

<sup>81</sup> Neni 320, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>82</sup> Neni 318, Kodi i Përkohshëm Penal.

më rënda siç janë pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale<sup>83</sup> ose sulm ndaj personave zyrtar.<sup>84</sup>

Në një rast tjetër pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj/Uroševac, me 16 korrik 2004 një gjyqtar dënoi dy të akuzuar për pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale. Gjykata, përtej dyshimit të arsyeshëm gjeti se së paku njëri nga të pandehurit, me 17 mars 2004 hodhi koktej Molotov në Kishën Ortodokse.<sup>85</sup> Këto fakte mbështesin dënim për veprë më serioze penale të nxitjes së rëndë të urrejtjes, mospajtimit dhe jo-tolerancës kombëtare, raciale, fetare ose etnike,<sup>86</sup> dhe/ose shkaktimit të rëndë të rrezikut të përgjithshëm.<sup>87</sup> Me 24 korrik 2007 Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë.

Në rastet e sipërme, prokurori ka mundur të sjell raste për akuza më serioze, bazuar në faktet e pandehura në aktakuzë. Si rezultat, disa kryes morën dënime të ulëta për shkak se nuk ishin akuzuar dhe dënuar për vepra adekuate penale.

### 5.3. Dënimet e ulëta

Sipas Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (“Kodi i Përkohshëm Penal”), “dënimi do të jetë në proporcion me veprën dhe sjelljen e rrethanat e kryesit.”<sup>88</sup> Veç kësaj një nga qëllimet e dënimet është të “të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.”<sup>89</sup> Gjyqtari, gjatë vendosjes së dënimet gjithashtu duhet të merr parasysh “shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, [dhe] rrethanat nën të cilat është kryer vepra [...]”<sup>90</sup>

Rreziku i kanosur me 17 dhe 18 mars 2004 për jetën, integritetin fizik dhe pronën private (përfshirë godinat fetare) të komuniteteve jo-shqiptare do të duhej të kishin ftuar qartazi në vendosje të dënimeve të rrepta kundrejt atyre që shpërndajnë urrejtje etnike në mes të grupeve të ndryshme etnike në Kosovë. Gjykatat është dashur të dërgojnë porosi të qartë se incidente të tilla nuk do të përsëriten.

Përkundrazi, OSBE vazhdoi të vërej tendencë të gjykatave të Kosovës drejt butësisë, veçse të theksuar në raportin e parë lidhur me trazirat e marsit.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë/Đakovica, gjyqtari shpalli fajtor pesë të pandehur për nxitje të urrejtjes, armiqësisë ose mospajtimit kombëtar, racial ose fetar, veprë penale që parasheh dënim prej minimum tre

<sup>83</sup> Neni 320(1), Kodi i Përkohshëm Penal. Si sulmi i dhunshëm ndaj policisë ashtu edhe djegia e shtëpive të serbëve të Kosovës (që nuk quan në akuza penale) do të duhej të qonin në akuza më serioze.

<sup>84</sup> Neni 317(1), Kodi i Përkohshëm Penal. Vepra e pjesëmarrjes në grup që pengon personat zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare (neni 318, Kodi i Përkohshëm Penal), nuk përfshin përdorimin e forcës, një veprë që nënkupton *sulmin* ndaj personave zyrtar (neni 317, Kodi i Përkohshëm Penal).

<sup>85</sup> Për çudi, edhe për një incident kaq serioz që përfshin shkatërrimin e monumenteve fetare dhe rrezikun ndaj jetëve të njerëzve, gjykata vendosi dënim (katër muaj) vetëm pak mbi minimum (tre muaj) të paraparë sipas nenit 320(1) të Kodit të Përkohshëm Penal. Aktgjykimi gjithashtu bën të ditur se dy të pandehurit tjerë morën pjesë në trazirat e ditës së nesërme (18 mars).

<sup>86</sup> Neni 115(3), Kodi i Përkohshëm Penal (që parasheh burgim prej një deri në tetë vjet).

<sup>87</sup> Neni 291(5), Kodi i Përkohshëm Penal (që parasheh burgim prej një deri në tetë vjet).

<sup>88</sup> Neni 64(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>89</sup> Neni 34(2), Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>90</sup> *Id.*

muaj burg.<sup>91</sup> Me 31 mars 2006 gjykata dënoi të pandehurit me dënim pak mbi minimum ligjor (katër muaj) dhe suspendoi dënimin për një vjet.<sup>92</sup>

Në një tjetër rast pranë Gjykatës Komunalë në Lipjan/Lipljane një i pandehur u përball me akuza të sulmit ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare.<sup>93</sup> Me 5 korrik 2007 gjykata e dënoi atë me minimumin ligjor (tre muaj burgim) dhe gjithashtu suspendoi dënimin.<sup>94</sup>

Si dëshmi shtesë në praktikën e përgjithshme të dënimeve të ulëta, në vetëm disa raste (vetëm ato me gjyqtarë ndërkombëtarë) gjykatat vendosën dënime mbi dënimet mesatare të lejuara me ligj. Shtojca II përmban tabelë që ilustron praktikën e dënimeve të gjykatave të Kosovës. Është shqetësuese se e shumta e dënimeve ishin afër minimumit ligjor.

#### 5.4. Dënimet nën minimum

Për më tepër, përkundër rekomandimeve në raportin e parë lidhur me trazirat e marsit, OSBE akoma monitoroi disa raste ku gjykatat vendosën dënime nën minimumin e paraparë me ligj, pa dhënë kurrfarë sqarime lidhur me rrethana lehtësuese.<sup>95</sup>

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë/Priština, gjyqtari gjeti se me 18 mars 2004, dy të pandehur vodhën një veturë që i përkiste një serbi të Kosovës, duke shfrytëzuar situatën e krijuar nga trazirat që po ngjanin. Me 12 nëntor 2007, gjykata i dënoi ata për vjedhje të rëndë,<sup>96</sup> vepër që parasheh dënim prej minimum gjashtë muaj burg. Megjithatë, të pandehurit u dënuan me katër respektivisht tre muaj burgim.

Në një rast tjetër, me 25 korrik 2005, Gjykata Komunale e Mitrovicë/Mitrovica dënoi një të pandehur për vjedhje të rëndë me minimumin ligjor prej gjashtë muaj burgim. Me 13 shkurt 2007 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica zvogëloi dënimin në tre muaj.

Në këto raste gjykatat nuk përmendën ndonjë rrethanë të veçantë lehtësues që do të arsyetonte dënimin nën minimumin e lejuar me ligj. Gjykatat madje as nuk e bën të ditur se dënimet e vendosura janë posaçërisht të buta.

#### 5.5. Shfrytëzim gjithëpërfshirës i dënimeve të suspenduara

Një “dënim i suspenduar” është ndëshkim alternativ kundrejt burgimit qëllimi i së cilit sipas Kodit të Përkohshëm Penal është, që “kryesit t’i jep qortimin i cili e arrin qëllimin e dënimit përmes shpalljes së dënimit *pa ekzekutimin e tij*.”<sup>97</sup> Ekzekutimi i

<sup>91</sup> Neni 134(2), Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Nr. 44, 8 tetor 1976.

<sup>92</sup> Shih paragrafin në vazhdim.

<sup>93</sup> Neni 317(1), Kodi i Përkohshëm, Penal.

<sup>94</sup> Për shënim, faktet e pandehura në aktakuzë mbështetin akuza për vepra më serioze të parapara me nenin 317(2), Kodi i Përkohshëm, Penal.

<sup>95</sup> Siç kërkohet nga neni 66 i Kodi të Përkohshëm, Penal.

<sup>96</sup> Neni 253, Kodi i Përkohshëm, Penal.

<sup>97</sup> Neni 42, Kodi i Përkohshëm Penal (theks i shtuar).



dënimit kështu suspendohet prej një deri në pesë vjet. Suspendimi mund të tërhiqet në qoftë se i pandehuri kryen vepër të re penale brenda periudhës së dhënë kohore.<sup>98</sup>

Përderisa dënimet e suspenduar kanë për qëllim që personat përgjegjës për vepra më të vogla t'i kursejnë nga përvojat traumatizuese siç është koha e kaluar në burg, OSBE është e shqetësuar nga shfrytëzimi i tepruar i dënimeve të suspenduara në kontekstin e rasteve të dhunës masive, siç janë trazirat e marsit të vitit 2004. Prej 86 personave të cilët gjatë periudhës së monitorimit (sipas njohurisë së OSBE-së)<sup>99</sup> ishin dënuar me burgim,<sup>100</sup> 49 (d.m.th. 56%)<sup>101</sup> morën dënime të suspenduara, derisa vetëm 37 (d.m.th. 44%) shërbyen kohën e dënimit në burg.<sup>102</sup>

## 6. PROBLEMET ME ANKESA

### 6.1. Dështimi për t'i korrigjuar mangësitë gjatë procedurave në shkallë të parë

Për derisa raporti i parë lidhur me trazirat e marsit bazohej kryesisht në monitorimin e rasteve në shkallë të parë, ky raport përfshin 27 raste me ankesë. Procedurat ankimore luajnë rol kyç në administrimin e drejtësisë në atë mënyrë që ato mund të ndihmojnë që të korrigjohen shkeljet dhe mangësitë e bëra në procedurat e shkallës së parë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjeti se “korrektësia e procedurës duhet të vlerësohet nga këndvështrimi i procedurës si tërësi”,<sup>103</sup> andaj duke përfshirë këtu edhe shkallën e ankesës. Gjykata njohu se disa defekte të shkallës së parë mund të adresohen dhe korrigjohen në shkallën ankimore.<sup>104</sup> Kështu, nëse gjykatat ankimore korrigjojnë mangësitë e bëra gjatë procedurës në shkallë të parë, në atë rast nuk ka shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sa i përket trazirave të marsit 2004, gjykatat ankimore në Kosovë shpesh kanë dështuar t'i adresojnë shkeljet procedurale dhe substanciale të bëra nga gjykatat më të ulëta. Në disa raste, shkeljet e mundshme në aktgjykimet e shkallës së patë janë lënë të pakorrigjuara për shkak të kryerjes së dobët të detyrës nga ana e prokurorit:

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj/Uroševac, prokurori parashtroi ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë të datës 16 korrik 2004 me të cilën tre të pandehur dënoheshin me katër muaj burgim, secili nga ta për pjesëmarrje në turmë që kryen vepër penale. Arsyetimi në ankesë thotë: “gjykata gjatë vendosjes së dënimit nuk ka vendosur dënim adekuat në këtë çështje penale” (përkthim jozyrtar). Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština mbajti një seancë dëgjimore në të cilën prokurori nuk mori

<sup>98</sup> Shih neni 45, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>99</sup> Përpos nëse ndryshe specifikohet, të dhënat në këtë raport janë siguruar përmes veprimeve monitoruese dhe nuk përfaqësojnë statistika zyrtare.

<sup>100</sup> Të dhënat përfshijnë aktgjykime të shkallës së parë si dhe ato me ankesë.

<sup>101</sup> Përqindja ngritet në 62.5% në qoftë se meren parasysh vetëm dënimet me burg që kanë të drejtë në suspendim (d.m.th nën dy vjet burgim).

<sup>102</sup> Veç kësaj, edhe pse ligji parashih se dënim mund të suspendohet për një periudhë verifikuese deri në pesë vjet (shih nenin 43(2), Kodi i Përkohshëm Penal), shumica dërmuese e dënimeve ishin suspenduar vetëm për një ose dy vjet.

<sup>103</sup> Shih p.sh. *Sipavičius kundër Letonisë*, 49093/99, Aktgjykim, 21 shkurt 2002, paragrafi 27.

<sup>104</sup> Shih p.sh. *Dallos kundër Hungarisë*, 29082/95, Aktgjykim, 1 mars 2001, paragrafi 52, ku Gjykata gjeti se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pasi që “çfarëdo defekte gjatë procedurës pranë Gjykatës Regjionale ishin *ndrequr* pranë Gjykatës Supreme” (theks i shtuar).

pjesë, dhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt. Si rezultat, me 24 korrik 2007 Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština hodhi poshtë ankesën.<sup>105</sup>

Në këtë dhe raste tjera, ankesa e prokurorit nuk përputhej me kërkesat ligjore që një ankesë duhet t'i përmbaj "bazat për ta sfiduar aktgjykimin"<sup>106</sup> dhe një "sqarim lidhur me ankesë."<sup>107</sup> Ankesa e prokurorit pothuajse nuk përmbante arsyetim duke dështuar kështu të jap arsye mbi atë se pse do të duhej gjykata ankimore ta plotësojë aktgjykimin e shkallës së parë.

Në raste tjera, prokurorët dështuan ta parashtronjë ankesën brenda afatit prej tetë ditëve të caktuar me ligj,<sup>108</sup> duke çuar kështu në atë që gjykata ankimore t'i refuzojë ankesat atyre mbi baza procedurale.

Në një rast, me 13 dhjetor 2005 Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica liroi nga akuzat dy të pandehur për vjedhje të rëndë.<sup>109</sup> Prokurori komunal nuk parashtrroi ankesë brenda tetë ditëve, duke ja shkelur kështu përfundimisht të drejtën për ankesë. Megjithatë, ai parashtrroi një ankesë me 12 tetor 2005 të cilën Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica e hodhi poshtë si të pas-afatshme.<sup>110</sup>

Në këtë rast, prokurori nuk veprroi me zellin e duhur të kërkuar,<sup>111</sup> duke dështuar kështu t'i kryej detyrat e veta në mënyrë "korrekte, konsistente dhe ekspeditive."<sup>112</sup> Si rezultat disa shkelje të mundshme të procedurës në shkallë të parë, përfshirë këtu edhe lirimin kontrovers të të pandehurve nga akuzat mbetën të paadresuara.<sup>113</sup>

Në raste tjera, prokurori as që ka tentuar të kundërshtojë aktgjykimin e shkallës së parë duke dështuar kështu të korrigjojë parregullsitë procedurale ose substanciale.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Prizren, me 15 shtator 2004 trupi gjyquese shpalli fajtor një të pandehur për një akuzë të sulmit të rëndë ndaj

<sup>105</sup> Për shënim, procedura pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština zgjati më shumë se tre vjet.

<sup>106</sup> Sipas nenit 402 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, "[n]jë aktgjykim mund të sfidohet: (1) Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale; (2) Për shkak të shkeljes së Ligjit Penal; (3) Për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose (4) Për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit."

<sup>107</sup> Neni 401, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>108</sup> Shih neni 400, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale. Megjithatë vlen të ceket se nëse i akuzuari është dënuar me burg ai mund ta kundërshtoi aktgjykimin deri në 15 ditë pas pranimit të kopjes së aktgjykimimit në formë të shkruar (shih neni 400(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale).

<sup>109</sup> Neni 200(1), Ligji Penal i Kosovës.

<sup>110</sup> Vendimi i Gjykatës së Qarkut është i datës 15 korrik 2007. Për shënim, sipas nenit 407(2) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, "Ankesa e paraqitur jashtë afatit [...] me aktvendim hedhet nga kryetari i trupit gjyqesues i gjykatës së shkallës së parë" (theks i shtuar). Andaj, Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica (jo Gjykata e Qarkut) është dashur t'i hedh poshtë ankesat.

<sup>111</sup> Sipas Komitetit për të Drejtat e Njeriut, autoritetet publike duhet të "ushtrojnë zell të duhur për të parandaluar, dënuar, hetuar ose korrigjuar dëmin e shkakuar nga shkelja e të drejtave të njeriut" (shih Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Koment i Përgjithshëm Nr. 31 [80], *Natyra e Obligimit të Përgjithshëm Ligjor të Vendosur në Shtetet Anëtare të Konventës*, 29 mars 2004, paragrafi 8).

<sup>112</sup> Shih Udhëzues për Rolin e Prokurorëve, e adoptuar në Kongresin e Tetë të Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kryesve, Havana, Kubë, 27 gusht deri me 7 shtator 1990, Udhëzimi nr. 12.

<sup>113</sup> Shkeljet tjera të mundshme përfshinin dëshmi të papranueshme dhe arsyetim jo-konsistent të aktgjykimimit të shkallës së parë.

personave zyrtarë, një akuzë të sulmit ndaj personave zyrtarë dhe një akuzë për pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale. Gjykata e dënoi atë me dënim të përgjithshëm prej 20 muaj burgim, të suspenduar për tre vjet. Më pas i pandehuri kundërshtoi aktgjykimin pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren mbi baza procedurale. Në aktgjykimin e vet të datës 26 janar 2007, gjykata e shkallës së dytë jo vetëm që e hodhi poshtë ankesën e të pandehurit pro gjithashtu gjeti se dënimi ishte shumë i ultë krahasuar me seriozitetin e sjelljes së të pandehurit. Megjithatë, mungesa e ankesës nga ana e prokurorit ndaloi vendosjen e dënimit më të rreptë.

Përfundimisht, OSBE gjithashtu vërejtë shembuj ku gjykatat e ankesës bënë shkelje të reja siç është vendosja e dënimeve nën minimumin ligjor.

Në një rast pranë Gjykatës Komunale në Mitrovicë/Mitrovica, me 25 prill 2005 gjykata gjeti fajtor një të pandehur për pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale gjatë trazirave të marsit 2004,<sup>114</sup> dhe e dënoi atë me minimumin ligjor, dënim të suspenduar prej tre muaj burgim. Me 16 nëntor 2006, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica konsideroi se dënimi i suspenduar nuk ishte “i mjaftueshëm për ta arritur qëllimin e dënimit”, andaj edhe vendosi ta ndërroj atë me vuajtje efektive të dënimit me burg. Megjithatë duke bërë këtë, gjykata gjithashtu zvogëloi dënimin në dy muaj, që është nën minimumin ligjor.

Në një tjetër rast, me 22 qershor 2004 Gjykata Komunale në Prishtinë/Priština gjeti një të pandehur fajtor për vjedhje të rëndë dhe dënoi atë me gjashtë muaj burgim, minimumi ligjor. Me 16 dhjetor 2005, Gjykata e Qarkut me ankesë zvogëloi dënimin e shkallës së parë në katër muaj. Gjykata e Qarkut nuk dha arsye për zvogëlimin e dënimit nën minimumin ligjor.

Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, gjykatat ankimore dështuan t’i adresojnë shkeljet e mundshme të proceduarve në shkallë të parë. Si rezultat, shumë shkelje dhe mangësi të vërejtura në aktgjykimet e shkallës së parë në rastet e trazirave të marsit 2004, mbeten të pakorrigjuara.

## **6.2. Zyra e Prokurorit të Kosovës mban shkresat e lëndëve**

OSBE gjithashtu vërejtë se disa procedura me ankesë në rastet e trazirave të marsit 2004 janë duke kaluar nëpër vonesa qenësore dhe shpesh të pajustificueshme. Në disa raste, këto vonesa ndodhin për shkak të mbajtjes së lëndëve nga Zyra e Prokurorit të Kosovës. Kolegji për ankesa nuk cakton seancën ankimore derisa zyra e prokurorisë të mos e kthej dosjen. Shqetësuese është se dispozita e aplikueshme sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale nuk parasheh afat kohor specifik për kthimin e lëndës me ankesë pranë kolegjit ankimor.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjeti se kohëzgjatja e arsyeshme e gjykimin penal duhet të vlerësohet nga këndvështrimi i kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurës. Andaj, garancia e “kohës së arsyeshme” zgjat nga data e akuzës deri në

<sup>114</sup> Neni 320(1), Kodi i Përkohshëm Penal.

vendosjen e saj përfundimtare, “që përfshin procedurën ankimore.”<sup>115</sup> Veç kësaj, kur vlerësohet se a është kohëzgjatja e arsyeshme, duhet të merret parasysh ndërlíkueshmëria e lëndës, sjellja e paraqitësit të kërkesës, sjellja e autoriteteve publike dhe se në çfarë ka në dispozicion paraqitësi i kërkesës.<sup>116</sup>

Sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, procedura duhet të mbahet pa vonesa.<sup>117</sup> Megjithatë, pa vendosur afat specifik kohor, ligji parasheh se gjykata e shkallës së dytë do të dërgojë lëndën me ankesë te “prokurori publik kompetent i cili e shqyrton dhe pa vonesë ja kthen gjykatës.”<sup>118</sup> Vetëm kur lënda kthehet në gjykatë nga ana e prokurorit publik, kryetari i kolegjit të ankesë cakton seancën ankimore.<sup>119</sup>

Megjithatë, OSBE ka monitoruar raste ku përfshiheshin ankesa pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, ku Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës ka mbajtur lëndët me ankesë për një kohë të gjatë të paarsyeshme.

Me 11 maj 2006 një kolegji ndërkombëtar i Gjykatës së Qarku në Prishtinë/Priština liroi një të pandehur nga dy akuza për vrasje<sup>120</sup> dhe katër akuza të vrasjes në tentativë,<sup>121</sup> kinse të kryera kundër serbëve të Kosovës me 17 mars 2004. Pas ankesës së prokurorit ndërkombëtar, Gjykata Supreme e Kosovës me 18 gusht 2006 ia dërgoi lëndën Zyrës së Prokurorit të Kosovës për të marr mendimin e saj. Megjithatë, deri me sot (d.m.th. për afërsisht 23 muaj më vonë) gjykata nuk ka pranuar përgjigje.<sup>122</sup> Rrjedhimisht, procedura ankimore veçse do të duhej të fillojë. Si rrjedhim, akoma pritet që procedura ankimore të fillojë.

Në një rast tjetër pranë kolegjit ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë/Priština, një i pandehur parashtri ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë të datës 22 korrik 2005 i cili e dënonte atë me 18 vjet burg për vrasje në tentativë të një serbi të Kosovës me 17 mars 2004.<sup>123</sup> Gjykata Supreme e dërgoi lëndën me ankesë në Zyrën e Prokurorit të Kosovës me 5 prill 2007. Deri më sot, (d.m.th. për afërsisht 15 muaj më vonë) prokurori nuk e ka kthyer lëndën dhe procedura ankimore ka ngecur.

Në rastet e sipërme, Zyra e Prokurorit të Kosovës ka mbajtur lëndët për kohë mundshëm të gjatë të paarsyeshme. Vonesa të tilla nuk duken të rezultojnë prej kompleksitetit të rasteve<sup>124</sup> e as sjelljes së të pandehurit.<sup>125</sup> Më saktë, arsyetimi primar

<sup>115</sup> Shih p.sh. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Eckle kundër Gjermanisë*, 8130/78, Aktgjykim, 15 korrik 1982, paragrafi 76.

<sup>116</sup> Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Buchholz kundër Republikës Federative të Gjermanisë*, 7759/77, Aktgjykim, 6 maj 1981, paragrafi 49.

<sup>117</sup> Neni 5(2), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>118</sup> Neni 409(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>119</sup> Neni 409(3), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale.

<sup>120</sup> Neni 146, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>121</sup> Neni 146, lidhur me nenin 20, Kodi i Përkohshëm Penal.

<sup>122</sup> Për shënim, i pandehuri është suspenduar nga puna që kur është marr vendimi i gjykatës më të ulët.

<sup>123</sup> Gjykata e Qarkut gjeti se i akuzuari ishte pjesëtar i grupit që kishte goditur viktimën me shkop të metalit derisa ai po përpiqej të ik. Viktima nuk kishte vdekur nga shpërthimi por atij i kishin vënë zjarrin pas sulmit.

<sup>124</sup> Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut argumenton se në këto dy raste, kohëzgjatja në vendimet e gjykatave më të ulëta, ankesat e parashtruar dhe dëshmitë e prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor duhet të vlerësohen për të përcaktuar se a ishin të ndërlíkua rastet. Megjithatë në mendimin e OSBE-së, këta faktorë nuk e bëjnë domosdoshmërisht të ndërlíkua rastin. Veç kësaj, këto nuk e justifikojnë

i Zyrës së Prokurorit të Kosovës për vonesa duket të jetë ngarkesa e madhe më lëndë.<sup>126</sup> Megjithatë, sipas praktikës të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një vonesë e tillë është e pajustificueshme dhe mund të çojë në shkelje të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme.<sup>127</sup>

## 7. KONKLUZION

Sistemi i drejtësisë në Kosovës ka mundur të bëjë progres më të madh në ndjekjen penale të atyre përgjegjës për trazirat e marsit 2004. Të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në procedurën penale - policia, prokurorët, gjykatat dhe dëshmitarët - i kontribuuan mangësive.

Në disa raste, zyrtarët e policisë dështuan që me kohë t'i transferojnë kallëzimet penale, dhe të paraqiten në gjykime kur janë ftuar si dëshmitarë. Prokurorët shpesh dështuan t'i akuzojnë të pandehurit me vepra adekuate penale dhe të parashtrijnë me kohë ankesa mirë të arsyetuara për të korrigjuar mangësitë e mundshme të aktgjykimeve të shkallës së parë.

---

mbajtjen e lëndëve për më shumë se 15 muaj para se të komentojnë rreth meritave të ankesës. Përderisa në rastin e parë të përshkruar më lartë, i pandehuri ishte liruar nga paraburgimi në pritje të vendimit mbi ankesë, kjo nuk ka ndikim në detyrën për të vendosur me kohë mbi ankesë. Për më tepër, se në çfarë rrethana ndodhet i pandehuri është puna e tij ngase ai ishte suspenduar nga puna që prej inicimit të procedurës penale.

<sup>125</sup> Shih për shembull Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Kemmache kundër Francës*, Aktgjykim, 27 nëntor 1991, paragrafi 60.

<sup>126</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur se kur justifikimi i dhënë për vonesë në rast është ngarkesa e tej-zgatur me punë në sistemin gjyqësor, ka shkelje të garancisë së kohës së arsyeshme, pasi që shteti nuk ka marr masa të duhura të përballet me ngarkesën. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 8737/79, Aktgjykim, 13 korrik 1983, paragrafi 29.

<sup>127</sup> Komiteti për të Drejtat e Njeriut gjeti se vonesa prej 31 muajve ndërmjet dënimit dhe ankesës shkeli të drejtën e të pandehurit për gjykim pa vonesa të panevojshme duke shtuar që “në mungesë të arsytimit nga cilido Shtet anëtar, kjo gjetje do të bëhej në rrethana të ngjashme në raste të tjera” (shih Komiteti për të Drejtat e Njeriut, Komunikimi nr. 702/1996, *McLawrence kundër Jamajkës*, 18 korrik 1997, paragrafi 5.11). Shih nenin 14(3)(c) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Në disa raste, dëshmitarët (përfshirë këtu zyrtarët e policisë) dështuan të bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore, duke penguar kështu ndjekjet e suksesshme penale. Gjykatat dhe prokurorët shpesh nuk kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion për të siguruar deklaratat e dëshmitarëve.

Procedurat ankimore nuk kishin korrigjuar gjithmonë gabimet procedurale ose substanciale të aktgjykimeve të shkallës së parë. Veç kësaj, vonesat e paarsyeshme të rasteve kanë ndaluar sistemin e drejtësisë për të dërguar porosi të qartë dhe të shpejtë se dhuna etnike nuk do të tolerohet në Kosovë.

Në shumë raste të monitoruara gjykatat kanë dështuar të marrin parasysh rrethanat rëndësuese (siç është motivi etnik) dhe vendosën dënime shumë të buta. Përderisa shumica e dënimeve ishin përbrenda parametrave të lejuar me ligj, është dashur që gjyqtarët t'i dënojnë më ashpër kriminelët, në veçanti në rastet ku veprat dukeshin të kenë qenë etnikisht të motivuara. Megjithatë, me përdorim të gjerë të dënimeve të suspenduara sistemi i drejtësisë së Kosovës në të shumtën e rasteve nuk ka siguruar që ata të cilët kanë kryer krime gjatë trazirave të marsit 2004 të dënohen në mënyrë adekuate.

## **8. REKOMANDIME**

### **Shërbimi Policor i Kosovës duhet:**

- Që në mënyrë të shpejtë t'i kryej hetimet lidhur me veprimtarinë e pandehur kriminale që ka ndodhur gjatë trazirave të marsit 2004, dhe pa vonesë t'i transferojë lëndët tek prokurori.
- Të sigurojë që zyrtarët e policisë të paraqiten me përpikëri para gjykatës kur ata ftohen si dëshmitarë.
- Në përputhje me Politikën e Shërbimit Policor të Kosovës dhe Manualit Procedural të ndërmer masa disiplinuese ndaj zyrtarëve të policisë që dështojnë të paraqiten ose ndryshojnë deklaratat e tyre pranë gjykatës.

### **Prokurorët e Kosovës duhet:**

- Të akuzojnë personat për pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale vetëm si opsjon të mbetur. Duhet të marrin parasysh me kujdes se a ekzistojnë elemente për vepra më serioze penale (siç janë shkaktim i rrezikut të përgjithshëm ose nxitje e urrejtjes kombëtare).
- Të marrin parasysh akuzime alternative dhe/ose kumulative.
- Të parashtrajnë me kohë ankesa të arsyetuara mirë kundër aktgjykimeve të papranueshme të shkallës së parë.
- Të akuzojnë për dëshmi të rrejshme dëshmitarët të cilët nuk deklarojnë të vërtetën.

### **Gjykatat e Kosovës duhet:**

- Që me kujdes të vlerësojnë se a përputhet situata faktike e përshkruar në aktakuza me kualifikimet ligjore të bëra nga prokurorët. Kur të konfirmojnë aktakuzat, në qoftë se është e nevojshme duhet t'i ri-kualifikojnë akuzat në atë mënyrë që të reflektohet serioziteti i veprimit të pandehurit.
- Motivin etnik të veprës penale ta trajtojnë si rrethanë rëndësuese.
- Të vendosin dënime që përputhen me seriozitetin e veprimit të pandehurit.
- Të vendosin dënime të suspenduara vetëm në raste më pak serioze. Duhet t'i shmangen vendosjes së dënimeve nën minimumin ligjor.
- Të ndërmarrin masa të duhura për të siguruar prezencën e dëshmitarëve gjatë gjyqimit. Të raportojnë tek komandat përkatëse zyrtarët e policisë të cilët dështojnë të paraqiten pranë gjykatës.
- T'i prishin aktgjykimet e shkallës së parë të cilëve i mungon arsyetimi i duhur në lidhje me vendimin ose dënimin.

### **Ligjvënësi:**

- Rekomandohet që neni 409(1) i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës të ndryshohet në atë mënyrë që të vendos afat kohor specifik në bazë të së cilit prokurori publik duhet të ja kthej lëndën me ankesë kolegjit për ankesa. Si alternativë, rekomandohet që një kopje e lëndës me ankesë të i dërgohet prokurorit publik dhe një afat kohor për të caktuar seancën ankimore do të duhej të përcaktohet me ligj.

### **Instituti Gjyqësor i Kosovës:**

- Rekomandohet që gjyqtarëve dhe prokurorëve të u ofrohet trajnim mbi përpilim të aktakuzave, ankesave penale, mbi rrethana rëndësuese/lehtësuese dhe matjen e dënimit.

## ANEKS I

Shërbimi Policor i Kosovës pranoi përafërsisht 1,400 ankesa për vepra lidhur me trazirat.<sup>128</sup>

Sipas statistikave të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, prej prillit të vitit 2008 një numër i përgjithshëm prej 36 të pandehurve janë ndjekur penalisht nga ana e prokurorëve ndërkombëtar. Akuzat përfshijnë vepra penale të vrasjes së rëndë, nxitje e urrejtjes etnike dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm. Nga këta 36 të pandehur, 14 morën dënime me burg dhe 21 dënime të suspenduara ndërsa njëri ishte liruar nga akuzat. Prokurorët ndërkombëtar janë duke vazhduar hetimet ndaj disa të dyshuarve të tjerë.<sup>129</sup>

Prej prillit të vitit 2008, sipas statistikave të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut<sup>130</sup> dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës,<sup>131</sup> prokurorët vendor kishin ngritur akuza penale kundër 206 të pandehurve që ka rezultuar në dënimin e 150 të pandehurve në gjykatat komunale dhe të qarkut. Në gjykatat për kundërvajtje, 116 individ janë gjetur përgjegjës për raste në të cilat përfshihen 157 persona.<sup>132</sup>

Gjatë periudhës së monitoruar nga OSBE (dhjetor 2005 deri në mars 2008) gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtar kanë trajtuar shtatë raste (në të cilat ishte ngritur aktakuza), që përfshinin 18 të pandehur. Gjykatat dënuan 17 dhe liruan një të pandehur. Dënimet radhiteshin prej minimum 21 muaj deri në maksimum prej 16 vjetëve. Gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë në përgjithësi ndoqën veprat më serioze penale që përfshijnë vrasje, vrasje në tentativë, nxitje të urrejtjes nacionale dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm.

Gjyqtarët dhe prokurorët vendor, gjatë periudhës së monitorimit trajtuan 61 raste (në të cilat ishte ngritur aktakuza), që përfshinin 105 të akuzuar.<sup>133</sup> 72 të pandehur ishin dënuat, 13 ishin liruar nga akuzat përderisa procedura ndaj 24 të akuzuarve është duke vazhduar. Dënimet radhiteshin prej dy muaj deri në 18 muaj. Vepra më e zakonitë e pandehur penale ishte pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale (51 akuza) dhe vjedhje e rëndë (21 akuza). Veprat tjera të pandehura penale përfshinin sulmin (ose pjesëmarrjen në grup që pengon) e personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nxitje të urrejtjes nacionale dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm. Gjatë periudhës së monitorimit OSBE po ashtu monitoroi pesë procedura për kundërvajtje.

<sup>128</sup> Veprat përfshinin 19 vrasje, 14 vrasje në tentativë, 36 sulme të rënda, 83 sulme, 629 zjarrvënie, 121 vjedhje me thyerje, 247 dëme penale, 33 grabitje, 12 sulme me granatë, 20 plaçkitje dhe 153 vjedhje (burimi: UNMIK, Shënime për media - Njoftimi lidhur me ndjekjet penale dhe dënimet lidhur me trazirat e marsit 2004, 14 mars 2008).

<sup>129</sup> *Të dhëna nga Departamenti i Drejtësisë (prill 2008 njoftim) mbi Vlerësimin Teknik të Progresit në Implementimit të Standardeve për Kosovë*, përgatitur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë, 29 shkurt 2008, paragrafi 25.

<sup>130</sup> Informacion i dhënë OSBE-së nga një zyrtar i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut me 30 prill 2008.

<sup>131</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Informacion i azhurnuar lidhur me rastet e trazirave të marsit 2004* (prill 2008), i dhënë OSBE-së nga një zyrtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me 25 prill 2008.

<sup>132</sup> Me gjasë nuk ka më raste të trazirave të marsit pranë gjykatave për kundërvajtje (shih Njoftimin e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (prill 2008) mbi Vlerësimin Teknik të Progresit në Implementimit të Standardeve për Kosovë, përgatitur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovë, 29 shkurt 2008, paragrafi 25.

<sup>133</sup> Këto të dhëna përfshijnë gjykatat komunale dhe të qarkut.



Vlen të ceket se prokurorët ngritën aktakuzë vetëm pas dhjetorit të vitit 2005 në 21 raste gjatë periudhës së monitorimit (ku përfshiheshin 42 të pandehur). Andaj, në dy vjet e gjysmë të kaluara ka pasur vetëm 21 raste të “reja” të trazirave të marsit 2004 në Kosovë pranë gjyqtarëve vendor ose ndërkombëtarë. Bilanci i rasteve përfshinte vazhdimin ose ankesat e rasteve të monitoruara gjatë raportit të parë lidhur me trazirat e marsit.

<b>RASTET E TRAZIRAVE TË MARSIT TË MONITORUARA NGA OSBE NDËRMJET DHJETORIT 2005 DHE MARSIT 2008</b>		
<b>Numri i rasteve</b>	Para gjyqtarëve ndërkombëtar	7
	Para gjyqtarëve vendor	61
	Në gjykatat për kundërvajtje	5
	<b>Total</b>	<b>73</b>
<b>Numri i të pandehurve</b>	Para gjyqtarëve ndërkombëtar	18
	Para gjyqtarëve vendor	105
	Në gjykatat për kundërvajtje	5
	<b>Total</b>	<b>128</b>
<b>Të pandehurit e dënuar ose të gjetur përgjegjës</b>	Para gjyqtarëve ndërkombëtar	17
	Para gjyqtarëve vendor	73
	Në gjykatat për kundërvajtje	1
	<b>Total*</b>	<b>91</b>

\*Për procedurat penale pranë gjykatave komunale dhe të qarkut “rast” definohet ai në të cilin është ngritur aktakuzë.

<b>NUMRI I PËRGJITHSHËM I RASTEVE TË TRAZIRAVE TË MARSIT (MARS 2004 DERI NË MARS 2008)</b>		
<b>Numri i të pandehurve</b>	Para gjyqtarëve ndërkombëtar	36
	Para gjyqtarëve vendor	206
	Në gjykatat për kundërvajtje	157
	<b>Total</b>	<b>399</b>
<b>Të pandehurit e dënuar ose të gjetur përgjegjës</b>	Para gjyqtarëve ndërkombëtar	35
	Para gjyqtarëve vendor	150
	Në gjykatat për kundërvajtje	116
	<b>Total</b>	<b>301</b>

**ANEKS II**  
**Dënimet e Gjykatave të Kosovës në Rastet e Trazirave të Marsit 2004**  
**të Monitoruara nga OSBE<sup>134</sup>**

	<b>Nr. i rasteve</b>	<b>Dënimi Minimum/Maksimum</b>	<b>Dënimi mesatar në rastet e trazirave të marsit 2004</b>
<b>Vjedhje e Rëndë</b>	7	6 muaj deri në 5 vjet	4.3 muaj
<b>Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale</b>	26	3 muaj deri në 3 vjet	6.2 muaj
<b>Pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtarë</b>	8	gjobë deri në 3f vjet	5.6 muaj

<sup>134</sup> OSBE ka monitoruar raste të lidhura me trazirat e marsit 2004 që ishin duke u proceduar para gjykatave të Kosovës ndërmjet dhjetorit 2005 dhe marsit 2008.